

Mësim praktik (Metoda e përpunimit) I

Projekt I mësimi praktik nga zeja e zdrukthtarisë

Tema: Gërryerja e një dërrase të rimesuar Ndërmjetësimi në bazë të planprogramit të vitit të dytë shkollor	
Vendmësimi	Punëtorja e zdrukthtarisë
Mjetet e shkollimit	1 palë fletore pune, 1 dërrasë e rimesuar, mjet koroziv, gome, dorëza gome, enë për ngjyrë, leckë, furçë
Koha e duhur	15 Minuta
Metoda	Metoda përpunuese e mësimi praktik
Qëllimet e mësimi	Nxënësi duhet në mënyrë të pavarur të bëjë gërryerjen e një sipërfaqeje të rimesuar duke pasë parasysh masat e sigurisë. Përparësi në qëllimin e mësimi kanë kompetenca profesionale dhe ajo metodike.
Fushat e qëllimit mësimor:	Qëllimet pjesore: Nxënësi
Qëllimet mësimore kognitive	<ul style="list-style-type: none">- Mund të përshkruajë se si e zhvillon punën në mënyrë të pavarur- Mund të sqarojë drejtimit e drurit- Mund të sqarojë se cilat masa të sigurisë duhet respektuar- Mund të caktojë veglat e duhura të punës si dhe të përshkruajë përdorimin e tyre- Mund të vlerësojë vetë punën e tij
Qëllimet psikomotorike	<ul style="list-style-type: none">- Mund të përdorë sipas nevojës veglat e punës- Mund të bëjë bartjen, shpërndarjen dhe tërheqjen e gërryerjeve në mënyrë të pavarur
Qëllimet mësimore afektive	<ul style="list-style-type: none">- Është i gatshëm të punojë me kujdes- Është i gatshëm të respektojë masat e sigurisë

1. Faza përgatitore

Përmbajtja e mësimi	Këshillat metodike
Paramendimi i temës	Këshillë, gërryerja është me rëndësi primare për profesion dhe sipas planprogramit shkollor duhet të ndërmjetësohet në vitin e dytë
Zgjidhja e interesit	Të ceket, se si rezultat i dëshirës individuale të klientëve për llojin e mobileve, shpesh është i nevojshëm ndërimi i tonit të drurit. Kjo mund të arrihet përmes gërryerjes. Nëse nevojitet, të rikujtohen në kërkesën e klientëve në kohën e fundit.
Sqarimi i qëllimit	Të përshkruhet shkurtimisht qëllimi i mësimi praktik dhe nxënësit ti sqarohet rëndësia e punës së pavarur dhe për këtë arsye priten nga ai zgjedhje të pavarura të ushtrimeve.
Përcaktimi i njohurive Paraprake	Të pyetet nxënësi se a e ka parë se si zhvillohet apo ndoshta edhe kryer ndonjëherë një punë të tillë. Të pyetet se çka nënkupton ai me termin „Gërryerje“ dhe mundësisht ta sqarojë këtë term. Të bisedohet shkurtimisht lidhur me përgatitjen e dërrasës së drurit si dhe për mjetet e nevojshme të punës (cilat mjete janë të nevojshme dhe pse).
Përpunimi i masave të sigurisë	Së bashku me nxënësin të lexohen rregullat e sigurisë mbi enën e ngjyrës (Dhënie të impulseve: Ai duhet të sqarojë, çka i bie ndërmend). Të pyetet për kuptimin. Të veçohen masat më të rëndësishme të sigurisë: <ul style="list-style-type: none">- Hapja e dritareve- Të mos pihet duhan- Përdorimi i dorëzave